



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 21.05.2019

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR TRAJTIMIN FINANCIAR, SUPLEMENTAR, TË PUNONJËSVE QË KANË
PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË, TË PUNONJËSVE TË INDUSTRIËS SË
NAFTËS E TË GAZIT DHE TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË
METALURGJI”**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 21.05.2019, mori në shqyrtim me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për trajtimin financiar, suplementar, të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Arben Ahmetaj.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin të pranishëm Z. Elton Haxhi, Zv. Ministër i Financave dhe Ekonomisë, Z. Bashkim Sala, Këshilltar i Ministrit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë e Z. Astrit Hado, Drejtor i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH).

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, të Kushtetutës dhe miratimi i tij i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës. Projektligji shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, objektivat dhe efektet e synuar të propozimit dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit:

Projektligji ka për qëllim të mundësojë trajtimin financiar, të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji. Ky trajtim financiar vjen përtej trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kjo nismë e Qeverisë vjen në vijim të një serë reformash dhe lehtësish të ofruara, për kategori të caktuara të popullsisë duke përbërë kështu një hap të mëtejshëm dhe shumë cilësor në përmbushjen e objektivave sociale të shtetit në kuadër edhe të përkujdesjes dhe ndihmës për të moshuarit dhe invalidët.

Projektligji iu dedikohet tre kategorive mjaft të veçanta punonjësish që kanë punuar në punë të vështira konkretisht në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës, si dhe në punë me një shkallë vështirësie shumë të lartë në metalurgji, duke iu mundësuar një trajtim financiar me të plotë dhe mbulim me përfitime, përpara kohës së mbushjes së moshës për pension si dhe përfitime shtesë, mbi ato që akordohen nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në mënyrë më konkrete, përfitues, sipas këtij projektligji, janë pensionistët që kanë përfituar pension sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, apo sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe pensionistët që kanë përfituar pension sipas ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, punonjësit që kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë dhe që do plotësojnë kushtet në vitet e ardhshme, punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhinieroteknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjiellës dhe gazsjiellës

si dhe punonjësit që kanë punuar në metalurgji, në profesione, punë shumë të vështira, shkrirje etj.

Objektivat dhe efektet e synuara të propozimit

Bazuar në legjislacionin në fuqi, punonjësit që kanë punuar në minierë dhe ata që kanë punuar në industrinë e naftës rregullohen me ligj të veçantë, respektivisht me ligjin nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë” dhe ligjit nr. 8/2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”. Pra ishin lënë pa mbulim të veçantë punonjësit të cilët kanë punuar në metalurgji.

Për sa më sipër, objektivi parësor i këtij projektligji konsiston në unifikim dhe trajtimin e barabartë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji si kategoria që janë përballuar më punë të vështira duke vlerësuar edhe shkallën e vështirësive, përmes akordimit të përfitimeve përpara kohës së mbushjes së moshës për pension si dhe përfitime shtesë mbi ato që akordohen nga legjislacioni për sigurimet shoqërore.

Një objektiv tjetër të rëndësishëm që synon të realizojë projektligji lidhet me përcaktimin qartësisht të periudhave të punës në atë industri që njihen për efekt të llogaritjes së përfitimeve të parakohshme apo të përfitimeve shtesë. Saktësohen gjithashtu dispozitat lidhur me llojet e përfitimeve, ri balancohen të drejtat si dhe harmonizohen kostot.

Projektligji ka në themel të objektivave të tij vendosjen e një skeme të njëjtë përfitimi suplementar që konsiston në tre elementë që janë:

- Pension për shkak të profesionit (llojit të punës);
- Shtesë mbi pensionin e pleqërisë;
- Shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

Për këto profesione janë parashikuar kushte lehtësuese dhe konkretisht, mosha e daljes në pension:

- Për minatorët 55 vjeç ose 10 vjet përpara moshës ligjore të daljes në pension sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.
- Për naftëtarët dhe metalurgët 60 vjeç ose 5 vite përpara moshës ligjore të daljes në pension sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Këtyrë kategorive u konsiderohet pension i plotë me 30 vjet pune gjithsej për burrat dhe 25 vjet për gratë.

Punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe punonjësit që kanë punuar në metalurgji, do të përfitojnë trajtimin financiar sipas këtij projektligji nëse kanë apo do të plotësojnë kushtet për të përfituar pension pleqërie, nëse kanë periudha sigurimi në profesion respektivisht:

- Për punonjësit e nëntokës 12.5 vjet;
- Për punonjësit e industrisë së naftës e të gazit: për disa kategori profesioni dhe pune (vështirësi) për burrat 15 vjet dhe për gratë 12.5 vjet dhe për disa kategori të tjera pune dhe profesioni (vështirësi) për burrat 20 vjet dhe për gratë 15 vjet;
- Për punonjësit e metalurgjisë: burrat 20 vjet, gratë 15 vjet.

Sipas parashikimeve të projektligjit është përcaktuar që:

- Masa e përfitimit mujor të pensionit për shkak të profesionit (llojit të punës), për të gjithë personat që plotësojnë kushtet e sipërcituara lidhur me periudhën e sigurimi në profesion, llogaritet rast pas rasti, sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë do të jetë për punonjësit e nëntokës, 1% të masës së pensionit të pleqërisë; për punonjësit e industrinë së naftës e të gazit dhe punonjësit e metalurgjisë, 0,6 % të masës së pensionit të pleqërisë. Këtë shtesë mbi pension, e përfitojnë të gjithë personat që kanë jo më pak se 6 vite në profesionet dhe punët e përcaktuara sipas këtij projektligji.
- Masa e përfitimit të shtesës për pension invaliditeti do të jetë në masën 1% për çdo vit vjetërsie pune në miniera, në nëntokë, industrinë e naftës dhe në metalurgji.

Nga vlerësimi i ndikimit të kësaj politike të re të trajtimit të kësaj kategorie punonjësit që janë përballur me punë të vështira, si pjesë e relacionin që shoqëron projektligjin vlerësohet se nga ky projektligj do të përfitojnë në total 23 400 persona, nga të cilët 7 600 në industrinë e naftës, rreth 13 300 minatorë dhe rreth 2 500 persona në metalurgji.

Për të bërë të mundur përfitimin nga skema sipas këtij projektligji, çdo përfitues do të duhet të aplikojë/bëjë kërkesë pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të vendbanimit të tij ose pranë sporteleve të shërbimit në ato bashki ku ndodhet vendbanimi i personit si dhe të mundësojë paraqitjen e gjithë dokumentacionit të nevojshëm i cili do të detajohen në mënyrë specifike në aktet nënligjore të ligjit.

Projektligji objekt shqyrtimi, shton trajtimin financiar për këtë kategori punonjësit por ruan të paprekur skemën e sigurimeve shoqërore të detyrueshme e cila mbështetet në parimin kontributiv, në parimin e solidaritetit të brezave, lidhur me krijimin e të drejtave dhe mbulimin

e pagesave, në një formulë pensioni që bazohet në vitet e sigurimit dhe në madhësinë e kontributeve të paguara, e barabartë për të gjithë dhe pavarësisht nga veprimtaria ekonomike. Për këtë arsye, kjo skemë nuk mund të mbulojë përfitime të veçanta apo shtesë, të ndryshme nga parimet e përgjithshme. Çdo përfitim i veçantë mbetet të mbulohet me kontribute shtesë ose nga taksat e përgjithshme.

Në kushtet kur sistemi i pensioneve dhe çdo përfitim social i kësaj natyre kërkon mbulim me kontribute dhe duke njohur faktin se ish-punonjësit e nëntokës në trajtimin financiar të veçantë apo mbetur të papunë dhe pa mbështetje sociale, me kushte të plotësuara, nuk kane periudha të mbuluara me kontribute shtesë për përfitime të parakohshme, skema përcakton vendosjen edhe të një kontributi shtesë, prej 5%, që paguhet nga punëmarrësit dhe punëdhënësit aktualë, financime buxhetore për mbulimin e përfitimeve aktuale si dhe pjesë të efektit financiar që nuk mbulohet nga kontributi shtesë.

Përmbajtja e projektligjit:

Projektligji, “Për trajtimin financiar, suplementar, të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, propozon konkretisht sa më poshtë:

- Në nenin 1 të projektligjit përcaktohet qëllimi i projektligjit, pra dhënien e trajtimit financiar, punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, trajtimi ky përveç atij të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Në nenin 2 dhe 3 të projektligjit, përcaktohen përfituesit si dhe kushtet specifike që ato duhet të plotësojnë lidhur me profesionin dhe punën, vjetërsinë dhe periudhat e sigurimit etj.
- Në nenin 4 të projektligjit, përcaktohen llojet e përfitimit suplementar që konsistojnë në pensionin për shkak të profesionit (llojit të punës); shtesës mbi pensionin e pleqërisë dhe shtesë mbi pensionin e invaliditetit.
- Nenet 5 dhe 6 të projektligjit, përcaktojnë kushtet dhe masën e përfitimit sipas secilit lloj të përfitimit suplementar.
- Neni 7 i projektligjit, përcakton gamën e të drejtave për përfitimit të shtesës mbi pension duke sanksionuar kohën e parashkrimit, datën e përfitimit të tij, afatet dhe periudhat e tërheqjes, të drejtën e organit kompetent për të kërkuar shumat e dhëna tepër si dhe përcaktohen penalitetet me 4 fish të të dëmit të shkaktuar pavarësisht nga dënimi penal.

- Nenet 8, 9 dhe 10 të projektligjit, trajtojnë financimin e skemës duke përcaktuar se përfitimet sipas këtij projektligji financohen nga kontributet dhe nga buxheti i shtetit. Gjithashtu trajtohen përjashtimi nga tatimet i këtij përfitimi si dhe të drejtën për indeksim të përvitshëm të tij.
- Nenet 11, 12, 13 të projektligjit, sanksionohet qartësisht se të drejtat e njohura përmes ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, për personat në moshën mbi 48 vjeç, do të vazhdojnë të zbatohen edhe pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji. Gjithashtu përcaktohet se ky përfitim jepet me kërkesë të interesuarit. Llogaritja, caktimi, administrimi dhe pagimi i pensioneve që rrjedhin nga ky ligj bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave në fuqi për pensionet
- Neni 14, i projektligjit ka vendosur detyrimin për Këshillin e Ministrave për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij projektligji brenda 3 muajve nga hyrja e tij në fuqi.
- Neni 15 i projektligjit ka përcaktuar hyrjen në fuqi të këtij ligji 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare në respektim të përcaktimit kushtetues në nenin 84 të saj.

IV. Efekti Financiar

Referuar kushteve për pension, bazuar në të dhënat që disponohen, si dhe në numrin aktual të punësuarve në industrinë e naftës, parashikohet që:

- Numri i personave në industrinë e naftës që përfitojnë nga ky projektligj të arrijë në rreth 7 600, me një efekt financiar vjetor rreth 720 milionë lekë.
- Numri i përfituesve minatorë parashikohet të jetë rreth 13 300 persona dhe efekti financiar përlllogaritët rreth 520 milionë lekë në vit,
- Numri i përfituesve për metalurgjinë, parashikohet të jetë rreth 2 500, me një efekt financiar rreth 220 milionë lekë.
- Gjithsej, parashikohet të jenë 23 400 përfitues, me efekt financiar vjetor rreth 1 460 milionë lekë.

V. Konsultimi Publik

Janë kryer disa konsultime me sindikatat e minatorëve dhe persona të interesuar si dhe disa takime të grupit ndërinstitutional të punës.

Kërkesat e sindikatës së minatorëve kanë konsistuar në trajtimin e një statusi i veçantë dhe trajtim shtese pra jo vetëm përfitimet suplementare të pensionistëve si dhe është kërkuar që masa e shtesës të pensionit të jetë më e lartë.

Nga shqyrtimi i këtyre kërkesave të grupeve të interesit, grupi i punës ka vlerësuar nevojën për unifikim dhe trajtim të barabartë të atyre kategorive punonjësish që kanë punuar në punë të vështira duke vlerësuar shkallën e vështirësive së parë, përmes një trajtimi të veçantë financiar përtej atij të dhënë nga legjislacioni rregullues i fushës. Gjithashtu lidhur me masën e përfitimit është vlerësuar e nevojshme edhe njohja e së drejtës për indeksim sa herë indeksohen edhe pensionet.

VI. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij bëri një pasqyrim dhe analizë të detajuar të projektligjit. Ai u shpreh se ky projektligj, është një premtim i mbajtur i Qeverisë për të tre profesionet, naftëtarët, minatorët dhe metalurgët. Projektligj ka për qëllim të mbulojë me përfitime përpara kohës së mbushjes së moshës për pension, si dhe përfitime shtesë mbi ato që akordohen nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, për tre kategori mjaft të veçanta punonjësish të cilët kanë punuar në miniera nëntokë, në industrinë e naftës, si dhe në metalurgji. Bashkimi i këtyre punonjësve në një ligj të përbashkët është bërë për shkak të ngjashmërisë në lidhje me vështirësinë e punës dhe brenda këtij parimi janë bërë dallime në punë të vështira dhe shumë të vështira.

Projektligji sjell 3 risi të rëndësishme si më poshtë:

1. Përfitim suplementar për të treja profesionet;
2. Përfitim shtesë mbi pensionin e pleqërise për të tre profesionet duke iu referuar viteve bazike në punë me 1% dhe 0.6%.
3. Detyrimin ligjor për krijimin e skemës suplementare nëpërmjet kompanive private në mënyrë që ato punonjës që janë nën moshën 48 vjeç, të kenë mundësi të përfitojnë nga fondet e vetë krijuara me kontribute sipas detajimeve në legjislacionin përkatës.

Nuk është rasti i parë që një ligj hartohet për disa kategori të ndryshme punësh por me karakteristika të ngjashme dhe që adresojnë problematikë të njëjtë, të tilla si përfitimet suplementare për ushtarakët, policët, punonjësit e shërbimit informativ kombëtar, policisë së burgjeve, gardës së Republikës, zjarrfiksave. Këto grupe megjithëse kanë ligje dhe statute organizimi të veçanta përse i përket përfitimeve suplementare trajtohen sipas një ligji të përbashkët.

Për këto profesione objekt i projektligjit, janë parashikuar kushte lehtësuese dhe konkretisht, moshë e daljes në pension:

- Për minatorët 55 vjeç ose 10 vjet përpara moshës ligjore të daljes në pension sipas ligjit të sigurimeve shoqërore
- Për naftëtarët dhe metalurgët 60 vjeç ose 5 vite përpara moshës ligjore të daljes në pension sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Këtyre kategorive, u konsiderohet pension i plotë me 30 vjet pune gjithsej për burrat dhe 25 vjet për gratë ndërkohë që për të gjithë shtetasit e tjerë vjetërsia në punë për të përfituar pension të plotë është 37 vite dhe çdo vit shtohet me 4 muaj për të arritur 40 vjet. Vetëm nga ky favor çdo njëri prej këtyre kategorive ka një përfitim në masën e pensionit prej 1374 lekë në muaj.

Gjithashtu, është parashikuar që me plotësimin e moshës ligjore sipas ligjit të sigurimeve shoqërore, këta pensionistë do të marrin një shtesë mbi pension për minatorët 1% të pensionit të pleqërisë për çdo vit pune në nëntokë dhe naftëtarët dhe metalurgët 0.6 % e pensionit për çdo vit në këto profesione.

Relatori i projektligjit theksoi gjithashtu se ky përfitim shtesë nuk është i bazuar në kontribute por është totalisht i financiar nga buxheti i shtetit si mbështetje për punën e kryer.

Duke u bazuar në vjetërsinë minimale në profesion për të përfituar këto trajtime suplementare, del që minimalisht do të përfitojnë shtesë minatorët 12.5 % dhe naftëtarët dhe metalurgët 12 %. Pra, nga dalja parakohe në pension dhe shtesa mbi pension, këto kategori përfitojnë rreth 19 - 20% më shumë se para këtij projektligji. Në terma absolutë për pensionistët aktualë, referuar pensioneve mesatare të minatorëve prej rreth 23.000 lekësh vetëm nga ky projektligj përfitohet rreth 2900 lekë në muaj.

Për pensionistët e rinj, si minatorë kjo shtesë do të jetë edhe rreth 1400 më tepër si rezultat i uljes së vjetërsisë për të dalë në pension të plotë (nga 37 në 30 vjet). Për pensionistët aktualë që kanë punuar në naftë kjo shtesë shkon në masën 2900 lekë në muaj ndërsa ata që do të dalin në pension parakohe do t'ju shtohet edhe 1400 lekë. E njëjta llogari vlen edhe për metalurgët.

Përfitimet e këtij projektligji bazohen në vështirësitë specifike të secilit sektor. Sipas vendimit nr.526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni” të ndryshuar, minatorët në nëntokë janë kategoria më e vështirë e punë në kategorinë e parë, ndërsa naftëtarët dhe metalurgët klasifikohen si punë e vështirë e kategorisë së dytë. Kjo konfirmohet edhe nga niveli i pagave të pëcaktuara sipas shkallës së vështirësisë para vitit 1994 (kohë në të cilën kanë punuar minatorët). Paga e naftëtarit ka qënë rreth 78% e pagës së minatorit në nëntokës ndërsa e metalurgëve ka qënë rreth 81 % e pagës së minatorit nën tokë.

Përfitimet që marrin dhe shtesat që parashikohen për këto kategori, bëjnë që koeficienti i kthimit të kontributeve që llogaritet si raport i përfitimeve të marra ose që do të merren me kontributet e paguara ndër vite (të njehsuara) është 340% për minatorët (para për 1 lek kontribut marrin 3.4 lekë përfitim), 157 % për naftëtarët dhe metalurgët para për 1 lek kontribut marrin 1.57 lekë. Ndërkohë që për profesione të tjera si mësues dhe mjekë ky koeficient është afërsisht 100%.

Kështu, minatorët mesatarisht kanë paguar kontribute gjatë gjithë jetës 2.514.000 lekë dhe do të përfitojnë 8.556.000 lekë. Naftëtarët dhe metalurgët kanë paguar kontribute gjatë jetës 3.162.000 lekë dhe do të përfitojnë 4.968.000 lekë. Mësuesit kanë paguar 5.084.000 lekë si kontribut dhe do të përfitojnë 5.058.000 lekë, kjo për analogji dhe për të treguar se si i trajton qeveria profesionet e vështira, pasi diferenca paguhet nga Buxheti i Shtetit.

Ky projektligj sanksionon përkohshmërinë e këtyre përfitimeve, dmth që nuk vazhdon pafundësisht por në një afat të mëvonshëm shuhet. Kjo për faktin që sot këto industri janë private dhe duhet të gjejnë zgjidhje në fondet profesionale. Nuk ka detyrim shoqëria dhe shteti të privilegjojë në dalje në pension më herët apo shtesë pensioni për personat që punojnë në kompani private.

Është parashikuar që për këtë trajtim financiar shtesë që financohet nga buxheti i shtetit pa paguar kontribute suplementare, do ta përfitojnë pensionistët aktualë, punonjësit që aktualisht punojnë në këto industri dhe që sot kanë moshën 48 vjeç ose më shumë. Kjo për faktin se personat më të rinj se kjo moshë kanë mundësi që nëpërmjet sigurimit suplementar në skemat profesionale të vetëfinancojnë pensionin suplementar.

Është parashikuar pagimi i kontributeve shtesë për ata që aktualisht punojnë dhe do të punojnë në këto industri në masën 5% për daljen parakohe (që është aktualisht për minatorët sipas përcaktimeve të ligjit 150/2014) +5 % për të financuar shtesën mbi pension.

Gjithashti Z. Ahmetaj, në fund të fjalës prezantuese të ligjit, paraqiti edhe dy amendamente konkretisht:

- Shtesën mbi pension ta përfitojnë edhe personat që marrin pension sipas ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, kur data e lindjes së të drejtës për pension është deri më 31.12.2014.
- Për personat që përfitojnë pension invaliditeti nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, të cilët kanë vjetërsi në profesion më pak se periudha e përcaktuar në neni 5 të këtij ligji, për efekt të shtesës mbi pension, vjetërsia në profesion llogaritet respektivisht për ish minatorët 12.5 vjet, për naftëtarët edhe metalurgët 20 vjet.”

Që të dy amendamentet u mirëpritën nga anëtarët e komisionit.

Në komision për qëllime të saktësimit të projektligjit u propozuan ndryshime dhe shtesa edhe nga deputetë të tjerë, një pjesë e të cilave u konsideruar dhe miratuan nga komisioni.

Njëzëri të gjithë anëtarët e komisionit, shprehën kënaqësinë për mundësimin e krijimit të kësaj skeme të trajtimit suplementar të kësaj kategorie punonjësit të cilët janë përballur me punë të vështira dhe shumë të vështira. Ky projektligj përmbush një premtim të mbajtur të qeverisë përkundrejt kësaj shtese të popullatës.

VII. Përfundime dhe ndryshimet e projekt aktit (nen për nen)

Në përfundim të shqyrtimit të projektligjit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar si tejet pozitive mundësinë që krijohet përmes këtij projektligji, për trajtimin financiar shtesë, përtej trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, për punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, si tre kategorive mjaft të veçanta punonjësish që kanë punuar në punë të vështira, me votat pro të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim nen për nen dhe në tërësi me ndryshimet e mëposhtme:

- Në titull dhe kudo në projektligj, përcaktimi “në miniera, në nëntokë” bëhet “në miniera në nëntokë”, duke hequr presjen.
- Neni 1, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është trajtimi financiar, i punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, përveç trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”

- Në nenin 2, të projektligjit bëhen këto ndryshime:
 - paragrafi i parë riformulohet me këtë përmbajtje:

“Përfitues, sipas këtij ligji, janë personat në profesione e punë, në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe në metalurgji, që iu njihet vjetërsia në punë dhe periudha e sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji e që njëkohësisht plotësojnë edhe kushtet e tjera të përcaktuara në këtë ligj, si më poshtë vijon:”

- në shkronjën “a”, saktësohen titujt e ligjeve të cilat referohen.
- në shkronjën “d” pas referencës “në krerët III, VIII e XII”, shtohen fjalët “të pasqyrës nr. 1” dhe në fund të fjalisë shtohen fjalët “të ndryshuar”.
- Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:
 - Vendosen numra përpara çdo paragrafi (me ndryshimet bëhen gjithsej 6 pika);
 - Në paragrafin e dytë, që bëhet pika 2 bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - në shkronjën “a” pas referencës “të krerëve I, XIII e XIV” shtohen fjalët “të pasqyrës nr. 1”;
 - në shkronjën “ç” pas referencës “krerët III, VIII e XII” shtohen fjalët “të pasqyrës nr. 1” dhe në fund të fjalisë shtohen fjalët “të ndryshuar”.
 - Paragrafi 3, ndahet në dy paragrafë që numërtohen pika 3 dhe 4 dhe riformulohen me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Për efekt përfitimi sipas këtij ligji, proceset e punës në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës dhe në metalurgji, pas datës 30.9.1993, do të njihen, nëse janë kryer dhe dokumentuar sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitet ekonomik në subjekte me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror si dhe në subjekte private.

4. Emërtimet e profesioneve dhe punëve si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr.526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”
 - Paragrafi i katërt bëhet pika 5, fjalët “në pikën 3” zëvendësohet me fjalët “në nenin 3” dhe referenca ligjore “sipas nenit 6” zëvendësohet me referencën ligjore “sipas nenit 8”.

- Paragrafi i fundit bëhet pika 6, përcaktimi “për këtë ligj” zëvendësohet me përcaktimin “për qëllime të këtij ligji”.
- Në nenin 5, pikën 1, shkronja “c”, paragrafi i fundit riformulohet me këtë përmbajtje:

“Kur nuk plotësohen kushtet sipas shkronjës “b” të këtij neni, periudha e punës sipas shkronjës “b” i shtohet periudhës së punës sipas përcaktimeve në shkronjën “c” të këtij neni. Në këtë rast, kushtet e përfitimit janë ato sipas shkronjës “c”, të këtij neni.”
- Në nenin 6, bëhen këto ndryshime:
 - Titulli i nenit 6 riformulohet “Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë dhe të shtesës mbi pensionin e invaliditetit”.
 - Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:
 - Në fillim të pikës 1, fjalët “Masa e përfitimit”, zëvendësohet me fjalët “Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë”.
 - Në shkronjën “a”, pas fjalëve “të cilët kanë përfituar”, shtohen fjalët “pension pleqërie”.
 - Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c. Shtesën mbi pension sipas shkronjës “a” të këtij neni, e përfitojnë edhe personat që marrin pension sipas ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, kur data e lindjes së të drejtës për pension është deri më 31.12.2014.”
 - Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:
 - Në fillim të pikës 2, fjalët “Masa e përfitimit për invalidët” zëvendësohet me fjalët “Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e invaliditetit”.
 - Paragrafi i parë i pikës 2, numërohet shkronja “a”
 - Pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf i ri shkronja “b” me këtë përmbajtje:

“b) Për personat që përfitojnë pension invaliditeti nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, të cilët kanë vjetërsi në profesion më pak se periudha e përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, për efekt të shtesës mbi pension, vjetërsia në

profesion, llogaritet respektivisht, për ish minatorët 12.5 vjet, për naftëtarët dhe metalurgët 20 vjet.”

- Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, paragrafi i fundit riformulohet me këtë përmbajtje:

“Shuma e kontributit varet nga paga totale (bruto) e punëmarrësit. Kontributi nuk mund të paguhet nën pagën minimale dhe mbi pagën maksimale mujore për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore.”

- Tre paragrafët e fundit numërtohen respektivisht 3, 4 dhe 5.

- Neni 13 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 13
Kërkesa për përfitim

Përfitimi, sipas përcaktimeve në këtij ligji, jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të vendbanimit të tij ose pranë sporteleve të shërbimit në ato bashki ku ndodhet vendbanimi i përhershëm i personit, së bashku me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe rregulloreve të ISSH-së.”

- Në nenin 14, fjalët “brenda 3 muajve” zëvendësohen me fjalët “brenda 2 muajve”.

RELATOR

Arben AHMETAJ

KRYETAR

Arben AHMETAJ